VENDIM
Nr. 85, datë 30.3.2021

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR, "ALBGAZ" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/6 prot., datë 29.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 1.3.2021, ka vendosur:

Të fillojë procedurën për miratimin e Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a.;

- Në vijim, duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria "Albgaz" sh.a., nuk ishte sqaruar ende plotësisht për përditësimin e konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263/2020 në Programin e përputhshmërisë e mund të ishte i nevojshëm dhe organizimi i një takimi virtual për këtë qëllim, si dhe duke mbajtur pasur parasysh faktin që shoqëria ishte në fazën e përkthimit të programit, i cili duhet dërguar dhe për opinionet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 1.3.2021, vendosi:

Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 30 ditë, për miratimin e Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a.

- Me shkresën e datës 18.3.2021, shoqëria ka kërkuar zgjatjen deri më 10.8.2021, të afatit të dorëzimit të Programit të përputhshmërisë, të përditësuar sipas konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 28.12.2020, me anë të të cilit filloi dhe procedura për miratimin e këtij programi.

- Në mbështetje të kërkesës së saj për zgjatjen e afatit, shoqëria bëri me dije se, duke qenë se nuk u realizua dot një takim për shkak të kushteve të COVID-19, për të sqaruar përfundimisht çështjet e ngritura në vendimin për fillimin e procedurës, shoqëria deklaroi se ka nisur një procedurë të brendshme për implementimin e sugjerimeve dhe se ndryshimet në Programin e përputhshmërisë duhet të miratohen në disa hallka drejtuese të brendshme të shoqërisë, si Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme e "Albgaz" sh.a.

- Lidhur me sa parashtruar nga shoqëria "Albgaz" sh.a., në shkresën e datës 18.3.2021, sqarojmë se afati i kërkuar nuk është i justifikuar dhe, për këtë arsye, gjykohet shtyrja e tij me 3 muaj, përkatësisht deri më 30 qershor 2021.

- Në nenin 53, pika 3, të Kodi të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

3. Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

Kërkesa e shoqërisë është depozituar brenda afatit të shtyrë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63/2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri më 30.6.2021 afatin e dorëzimit të Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftoj palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti